



Ndërmarrja Publike Lokale "HIGJIENA" SH.A –Deçan

RAPORTI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR VITIN 2021-2022

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Klientët.....

Faturimi

Inkasimi

Shpenzimet

Problemet dhe sfidat

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për periudhën kohore të vitit 2021-2022 paraqet një përmbledhje të gjitha aktiviteteve financiare të zhvilluara gjatë këtyre viteve.

Në raportin e punës për periudhën vitit 2021-2022 do të prezantohen në mënyrë të detajuar numri i klientëve të shërbyer, me të dhënat financiare që lidhen me afarizmin e kompanisë gjatë kësaj periudhe duke përfshirë edhe të hyrat e tërësishme, shpenzimet e krijuara, dhe të gjitha të dhënat e tjera të cilat lidhen me periudhën raportuese.

HYRJE

Bazuar në Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Ndërmarrje Publike, Statutin e NPL “HIGJIENA” sh.a. si dhe rregullorën e punës së kompanisë lidhur me hartimin e raporteve të punës dhe rezultatet e arritura gjatë periudhave të caktuara kohore, në vazhdim po e paraqesim raportin e punës për periudhën kohore 2021-2022

Në vazhdim të raportit do të prezantohen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat relevante të cilat janë të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të qartë për afarizmin e NPL “Higjiena” – Deçan gjatë kësaj periudhe.

KLIENTËT DHE KATEGORITË E TYRE

Në bazë të dhënave të NPL “Higjiena” Sh.A. për periudhën raportuese numri i klineteve që është faturuar në komunën e Deçanit për vitin 2021 është 7,966 ndërsa për vitin 2022 është 8,214 për klientët (klient rezident,klient jo rezident, biznese, komuna)

Nëse do ti krahasonim të dhënat për të njëjtën periudhë e njëjtë të vitit 2021 shohim se në vitin të 2022 kemi një rritje për 258 klientë

Në mënyra tabelare është paraqitur më poshtë.

NPL “Higjiena” Sh.A – Deçan

Kategoria e shërbimeve	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
Amviseri	7604	7391	213
Biznese	581	546	35
Institucione	20	20	0
K.K – Kontrata ‘‘Ne shtepi’’	1	1	0
Totali ;	8,214	7,966	258

Të hyrat

Për vitin 2021 kompania ka arritur që kërkesat tona ndaj klientëve të arrinin vlerën e faturimit prej 566,915.83 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2022 kemi një rritje të konsiderueshme me diferenc prej 18,062.43€, apo shprehur në përqindje 3,19 %

Paraqitja tabelare

Faturimi 2022	Faturimi 2021	Diferenca në shifra	Diferenca në %
584,978.26	566,915.83	18,062.43	3,19

INKASIMI

Në këtë periudhë raportuese të vitit 2022 kompania ka arritur që inkasimin e mjeteve nga klientët të arrinin vlerën prej 585,132,32 €, ku këtu përfshihet edhe kontrata “Në shtëpi” dhe një pjesë e borxhit të vitit 2021 i paguar në vitin 2022, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2021 kemi një rritje prej 121,090.27 .€ ,apo shprehur në përqindje 26.31 % .

Inkasimi 2022	Inkasimi 2021	Diferenca në shifra	Diferenca në %
585,132,32 €	463,223.05 €	121,090.27 €	26.31

SHPENZIMET E VITIT 2022 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2021

NPL “Higjiena” Sh.A – Deçan

Shpenzimet e ndodhura në vitin 2022 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë 2021.

Nr.	E M E R T I M I	Shpenzimet 2022	Shpenzimet 2021	Diferenca 2022-2021
1.	Paga Bruto	297,061.00 €	266,372,00 €	30,689.00 €
2.	Shpenzimet e Derivateve	106,075.99 €	67,422.52 €	38,653.47 €
3.	Shpenzimet e mirembajtjes	35,851.10 €	29,500.00 €	6,351,10 €
5.	Shpenzimet e deponisë	34,800.00 €	33,880.00 €	920 €
6	Shpenzimet për investime kapitale	53,352.91 €	46,379.30 €	6,973.61 €
6.	Shpenzimet te tjera (ipko, korenti,uji, sowftvare,GPS,matriali zyrtar,rreklama,matrial higjienik etj.)	32,502.00 €	31,465.00 €	1,037.00 €
	Totali	559,643.00 €	475,119.00 €	84,624.18 €

Nga tabela më lartë shohim që në krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të shpenzimeve për total 84,624.18 €, apo 17.81 %.

Aryseja e kësaj rritje janë rritja e shërbimit si në aktivitetin primar dhe sekondar ,poashtu investimi me kamion dhe vetura zyrtare që rrjedhimisht sjellë deri të rritja edhe shpenzimeve.

Problemet dhe sfidat gjatë kësaj periudhe

Viti 2022 është karakterizuar me një rritje të pa parashikuar të çmimeve , veçanërisht të derivateve. Këto rritje të çmimeve e kanë vështirësuar operimin normal të kompanisë dhe përmbushjen me kohë të obligimeve .

Deçan, janar 2023

